



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:050677

Datë: 10.09.2019

Numri i dokumentit: 00503052

P.nr. 239/18

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit Q. H. B. nga fshati S., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me nenin 31 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr.537-4/17 të dt.22.03.2017, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 04.09.2019, në prezencë të PSH Sahde Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit av. M. Q., muarrë dhe publikisht shpalli ndërsa me datën 10.09.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari Q. B., nga i ati H., e ëma S., e lindur K., i lindur me dt.20.07.1992, nga fsh. S., ku dhe tani jeton, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Me dt. 04.03.2017 rreth orës 23,10 minuta në fshatin S. Komuna e Suharekës, pikërisht në lokalit B. – D. në bashkëveprim i shkaktojnë lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmtojnë shëndetin e A. B., në atë mënyrë që deri sa ishin duke luajtur bilardo në momentin kur A. del nga lokali për të shkuar në shtëpi dalin Q. edhe M., Q. i drejtohet me fjalët “mos fol shumë se shumë po folish për ne” pastaj A. e godasin me shufra hekur – mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit, në pjesë të ndryshme të trupit, me çrast i shkaktojnë lëndime trupore, lëndime këto të përshkruara si në akt ekspertimin mjeko ligjor të dt.06.03.2017.

Këso dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me nenin 31 të KP.

Gjykata në kuptim të nenit 41,43,46,73,74,75,76 si dhe nenit 188 par. 2 lidhur me par.1 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

**DENIMIN ME GJOBË**

Të akuzuarit Q. B. ia shqipton denimin me gjobë në shumë prej **300 € (treqind Euro)**, i cili duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmeris së këtij aktgjykimi ,

poqëse denimi me gjobë nuk mund të realizohet as detyrimisht, i njëjti do të zëvendësohet me denim burgimi **prej 15 ditësh**, duke llogaritur për 20 €, të filluar me një ditë burg, konform nenit 46 paragrafi 3 te KP.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, në emër të ekspertit mjeko ligjor shumën prej 20 €, dhe në emër të taksës për kompenzim të viktimave të krimit shumën prej 30 €, të gjitha këto pas plotëfuqishmeris se këtij aktgjykimi.

I dëmtuari A. Z. B. nga fsh. S., për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

PTH në Prizren me aktakuzën PP.II.nr.537-4/17 të dt.22.03.2017, ka akuzuar Q. H. B. nga fshati S., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me nenin 31 të KP, aktakuzën të cilën gjatë seancës gjyqësore prej fillimit gjer në mbarimin e saj e ka përfaqësuar PSH Sahide Sefa, e cila në tërsi ngel pranë të dhënave si në aktakuzë, i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.04.09.2019 dhe në vetë pranimin nga ana e të akuzuarit në prani të mbrojtjes av. M. Q., ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërsi është vërtetuar se me dt. 04.03.2017 rreth orës 23,10 minuta në fshatin S. Komuna e Suharekës, pikërisht në lokalin B. – D. në bashkëveprim i shkaktojnë lëndime trupore dhe përkohësisht ia dëmtojnë shëndetin e A. B., në atë menyrë që deri sa ishin duke luajtur bilardo në momentin kur A. del nga lokali për të shkuar në shtëpi dalin Q. edhe M., Q. i drejtohet me fjalët “mos fol shumë se shumë po folish për ne” pastaj A. e godasin me shufra hekur – mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtim të shëndetit, në pjesë të ndryshme të trupit, me çrast i shkaktojnë lëndime trupore, lëndime këto të konstatuara në QKMF në Suharekë, sipas raportit mjekësor me nr. protokollit 5... të lëshuar nga Dr.B. B. dhe akt ekspertimi mjeko ligjor i dt.06.03.2017 i lëshuar nga dr.N. U..

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtim gjyqësor e ka pranuar fajsin.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 259 të KPP në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe poashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajsis, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuza, siq janë, raporti i oficerit me nr. 2017-GB-1..., të dt. 05.03.2017, raporti mjekësor i QKMF në Suharekë, nr. 5084 të lëshuar nga Dr. B. B., akt ekspertimi mjeko ligjor i dt.06.03.2017 i lëshuar nga dr.N. U., si dhe fotodokumentacioni, të cilat gjinden në shkresat e lëndës si prova materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata poashtu në tërsi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 248 nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hudhjen e aktakuzes, apo pushimin e procedurës penale si dhe nenit 253 te KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuzes, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimin e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjes së veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me nenin 31 të KP, gjykata ka

vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ia shqiptoi dënimin siqë është cek në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ka vlersuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KP.

Gjykata si rrethanë letësuese pati parasyshë se i akuzuari ka patur qëndrim korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tërsi të veprës së kryer, është penduar për veprën e kryer, kurse rrethan posaqerisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u muarr në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 452 par. 1 të KPP.

Vendimi me të cilin është i obliguar i akuzuari që të bëjë kompenzimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr. 239/18 të dt. 04.09.2019**

Sek. Juridike  
F. Kabashi

G j y q t a r i  
Robert Tunaj

**UDHËZIME JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e pranimin të tij ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftushme për palët dhe gjykatën.